

# AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “Invention Albania” SH.P.K.

## Neni 1 Formimi

Sot me datë 03.07.2024 mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në përputhje me Ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”, Kodin Civil dhe Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Invention Albania” SH.P.K.

Kjo shoqëri krijohet nga:

1. **Ervin Truka**, i datëlindjes 27.05.1983, lindur në Dibër dhe banues në Tiranë,

## Neni 2 Selia

Selia e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “Invention Albania” SH.P.K. është në adresën: **Lagja “Treg”, Sheshi “Faik Shehu”, dyqani në katin e parë Dyqani Nr.2, ndërtesa me numër pasurie Nr.20/419-N2, Zona kadastrale Nr.2932, pranë urës së qytetit, Peshkopi.**

## Neni 3 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Invention Albania” SH.P.K. është c pacaktuar.

## Neni 4 Objekti Veprimtarisë

1. Shërbime të teknologjisë dhe Informacionit dhe Elektronikës
2. Shërbim zhvillimi software, aplikacioneve web ose mobile dhe web faqeve.
3. Shërbim marketingu digjital.
4. Shërbim projektimi, realizimi, asistence dhe mirëmbajtje teknike të sistemeve informatike.
5. Shërbim hostimi, regjistrim domain dhe mirëmbajtje servera.
6. Shërbim i sistemeve të sigurisë informatike dhe rekuperimit të të dhënave.
7. Shërbim krijimi të paketave hardware sipas porosisë dhe riparim pajisjesh elektronike.
8. Shërbime Grafike dhe Audio Vizuale.



9. Shërbime konsulence dhe trajnimeve profesionale në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Elektronikës.
10. Të japë përfaqësi ekskluzive shoqërive vendase dhe të huaja
11. Të shërbejë si distributor i shoqërive dhe markave të ndryshme vendi dhe të huaja. Të përfaqësojë shoqëri të huaja.
12. Të kryejë shitblerjen me shumicë dhe pakicë të të gjitha materialeve dhe shërbimeve të lejuara nga legjislacioni shqiptar.

## **Neni 5**

### **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë “**Invention Albania**” SH.P.K. është 10.000 (Dhjetë mijë) Lekë, i ndarë në 1 kuota si vijon:

1. **Ervin Truka** : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 10.000 (Dhjetë mijë) Lekë që përbën **100%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

## **Neni 6**

### **Organet e Shoqërisë dhe Asambleja**

Organet drejtuese të shoqërisë “**Invention Albania**” SH.P.K. janë:

- Asambleja e Ortakëve, organi më i lartë vendim – marrës.
- Administrator i shoqërisë, është **Z.Ervin Truka**. Shoqëria do të administrohet nga **Z.Ervin Truka**, si administrator i saj, i cili përfaqëson shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

## **Neni 7**

Të drejtat e detyrat e asamblesë, organizimi i shoqërisë, marrëdhëniet me persona fizikë e juridikë vendas apo të huaj, shprehen në statut, i cili bashkë me aktin e themelimit janë dokumentat bazë të veprimtarisë dhe shërbejnë për zhvillimin e aktiviteteve të saj.

## **Neni 8**

Veprimtarinë e saj, shoqëria do t’a zhvillojë në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

## **Neni 9**

Të gjitha mosmarrëveshjet me persona fizikë ose juridikë si dhe me organet shtetërore zgjidhen me mirëkuptim, me anë të dispozitave të këtij akti, statutit dhe legjislacionit shqiptar dhe kur këto mjete nuk japin rezultat atëherë zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.



Ky Akt Themelimi hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **“Invention Albania” SH.P.K.** në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Tiranë. Në këtë ditë shoqëria **“Invention Albania” SH.P.K.** njihet si person juridik.

## **Neni 10**

1. Ky akt formulohet në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet në 1(një) kopje.
2. Ortakët e shoqërisë i japin të drejtën **Z.Ervin Truka**, të paraqitet pranë QKB-së dhe çdo institucioni tjetër për regjistrimin e shoqërisë **“Invention Albania” SH.P.K.**

### **ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**

**Ervin TRUKA**

*Ervin Truka*  
